



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:107196

Datë: 15.07.2019

Numri i dokumentit: 00408282

PKR.nr.100/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurve B. H. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e mbron av.Asdren Hoxha nga Prishtina, H. K. nga Gjilani, të cilin e mbron sipas autorizimit av.Hamdi Jashari, F. Sh. nga Gjilani, të cilin e mbron sipas autorizimit av. Ilir Shaqiri nga Gjilani dhe M. A. nga Kamenica, të cilin e mbron sipas autorizimit av.Sevdail Robelli nga Gjilani, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotopë dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 dhe 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.86/2018 e datës 21.06.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 11.07.2019 shpall, ndërsa më 12.07.2019 përpilon:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurëve:

B. H., nga babai dhe nëna, i lindur më në Cyhri të Zvicrrës, me vendbanim “.....” nr .19, Prishtine, i pamartuar, ka te kryer shkollen e mesme, i punesuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves dhe shtetas Zvicerran.

H. K., nga babai, e ëma, e lindur, data e lindjes, me vendbanim “.....” pnr, Gjilan, i pamartuar, ka te kryer shkollen e mesme, papunesuar, i gjendjes se varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves.

F. Sh., nga babai, e ëma e lindur Jashari, data e lindjesme vendbanim “ William Woker” – rruga nr.42,Gjilan, i pamartuar, ka te

kryer shkollen e mesme, i punesuar ne, i gjendjes se varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves.

M. A., nga babai, e ëma e lindur Ajvazi, data e lindjes, i lindur ne Cyhri, me vendbanim rruga “.....” pnr , Kamenice, i pamartuar, ka te kryer shkollen e mesme, i punesuar i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Zvicerran

JANË FAJTOR SEPSE

I

Më datën 18.05.2019 rreth 20:30, në rrugën “ Muharrem Ibrahimimi” në Gjilan, të pandehurit pa autorizim kanë poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes preparate të cilat me ligj janë të shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që Polica e Republikës së Kosovës pas pranimit të një informate ka ndaluar një veturë të llojit Golf ,e tabela 652-KS-253, në të cilën ishin 5 persona të dyshuar: B. H., F. Sh., H. K., M. A. të gjithë madhor dhe i mituri L. A. i cili ishte duke vozitur veturën dhe gjatë kontrollimit të asaj veture policia ka gjetur 1095.7 gram narkotikë të llojit “ Marihuanë” e të cilën sasi narkotike e kanë siguruar një ditë më parë në Prizren për çmimin prej 1200 €, e cila sasi e karkotikut konfiskohet nga ana e policisë.

- Me çka kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 dhe 31 të KPRK-së,

Andaj, në bazë të nenit 4,41,42,43,46,47, 69, 73,74,75 paragrafi 3,76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 233, 365, 450 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

I GJYKON

1.Të pandehurin B. H. i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **3000 €** (tre mijë) euro, dhe me dënim me burgim në kohë zgjatje prej 8 (tetë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.05.2019 deri më datën 24.06.2019, te cilat dënime do te ekzekutohen pas kalimit të afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishëmerisë së këtij aktgjykimi.

2.Të pandehurin H. K. i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **1500€** (njëmijë e pesëqind) euro, dhe me dënim me burgim efektiv në kohë zgjatje prej

6 (gjashtë) muaj, e me kërkesën e te pandehurit ky dënim i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 2.000,00 euro (dymijë), ashtu qe gjykata i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej **3.500,00** euro (tremijepesëqind), në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **18.05.2019 deri më datën 24.06.2019**, ashtu qe për çdo ditë të mbajtur në paraburgim do t'i llogaritet nga 20 euro, e te cilën gjobë do ta paguaj pas afatit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3.Të pandehurin F. Sh. i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 1500€ (njëmijë e pesëqind) euro, dhe me dënim me burgim efektiv në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e me kërkesën e te pandehurit ky dënim i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 2.000,00 euro (dymijë), ashtu qe gjykata i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej **3.500,00** euro (tremijepesëqind), në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **18.05.2019 deri më datën 24.06.2019**, ashtu qe për çdo dite te mbajtur ne paraburgim do t'i llogaritet nga 20 euro, e te cilën gjobë do ta paguaj pas afatit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

4.Të pandehurin M. A. i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 1500€ (njëmijë e pesëqind) euro, dhe me dënim me burgim efektiv në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e me kërkesën e të pandehurit ky dënim i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shumë prej 2.000,00 euro (dymijë), ashtu qe gjykata i shqipton dënim unik me gjobe ne shume prej **3.500,00** euro (tremijepesqinde), në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **18.05.2019 deri më datën 24.06.2019**, ashtu qe per qdo dite te mbajtur ne paraburgim do t'i llogaritet nga 20 euro, e te cilën gjobe do ta paguaj pas afatit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohen të pandehurit B. H., F. Sh., H. K., M. A. që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50,00 euro (psedhjete) sejcili prej tyre dhe shumat prej nga 50,00 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, **secili** prej tyre, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Konfiskohen sasia e narkotikut 1095.7 gram narkotikë e llojit “ Marihuanë” dhe e njëjta do të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vetura Golf IV, me tabela 652-KS-253 me nr. **i kthehet** ndërmarrjes private “ Kosumi Renta Car” SHPK me seli në Gjilan.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda 21.06.2019 ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr.86/2018 , ndaj të B. H., F. Sh., H. K., M. A., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 dhe 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar nga gjykata që ta shpall fajtor dhe t'i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari i trupit gjykues, më 11.07.2019 ka mbajtur seancën fillestare, në të cilën kësaj gjykate i janë dorëzuar 4 marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të pandehurit B. H., me mbrojtësin e tij av.Asdren Hoxha, të pandehurit H. K., me mbrojtësin e tij av. Hamdi Jasharin, të pandehurit F. Sh., me mbrojtësin e tij av.Illir Shaqiri dhe të pandehurit M. A., me mbrojtësin e tij av.Sevdail Robelli.

Gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Gjykata ka aprovuar këto marrëveshje për pranim të fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarëve

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mirë të të pandehurëve në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurëve pa asnjë hezitim, pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka konfiskuar 1095.7 gram narkotikë e llojit “ Marihuanë.

Ndërsa gjykata veturën e markës Golf IV, me tabela 652-KS-253, ka vendosur që t'ia kthen ndërmarrjes private “ Kosumi Renta Car” SHPK me seli në Gjilan, për arsye se Prokuroria nuk ka prezentuar asnjë provë, sipas të cilës zyrtarët-pronarët e kësaj kompanie të kenë ditur se tani të pandehurit do ta keqpërdorin veturën në fjalë. Nga ana tjetër automjetin me qira nga kjo kompani e ka marrë R. H. me date 16.05.2019, qe vërtetohet me procesverbalin mbi pranimin e automjetit në shërbim me NRF 601650428.

Gjithashtu Prokuroria nuk ka paraqitur ndonjë provë, se automjeti ka qenë i përgaditur-i destinuar me ndonjë bunker për fshehjen e narkotikut.

Gjykata të pandehurit i ka detyruar që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumat prej nga 50 (pesëdhjetë) euro për secilin prej tyre dhe shumat prej nga 50 (pesëdhjetë)€ per secilin prej tyre, në emër të viktimave të krimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti për Krime të Rënda
Më 12.07.2019

Sekretarja juridike;
Fikrete Destani

Kryetari i trupit;
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:107196
Datë: 15.07.2019
Numri i dokumentit: 00408282